



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 61 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-2008/28), neni 5 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.03/2023, për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna, neni 60 i Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 i dt. 11.09.2008, në seancën e I-rë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Dragashit me dt. 22.12.2025 pas votimit paraparak, miratohet ky:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE NË KOMUNËN E DRAGASHIT

I

z. Fejsal Halilović me nr. personal 1172158419, nga minoriteti shumicë Goran, zgjedhet Nënkyetar për Komunitete në Komunën e Dragashit.

II

Mandati i Nënkyetarit të Komunës së Dragashit nga radhët e Komuniteteve, zgjat deri në përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, përkatësisht deri sa mos të vendoset ndryshe nga Kuvendi i Komunës në Dragash siç është i paraparë me Ligjet dhe aktet nënligjore të cilat janë në fuqi.

III

Me rastin e zgjedhjes, Nënkyetarit të Komunës për Komunitete, i takojnë të drejtat ligjore e materiale.

IV

Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhoj efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

I dërgohet:

- z. Fejsal Halilović,
- Zyrës së Kryetarit të Komunës së Dragashit,
- Zyrës personelit,
- Drejtorisë për Financa, Ekonomi e Zhvillim në Dragash,
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 060/01-28138-4/25

Dt. 22.12.2025

Kryesuesi i Kuvendit:

Resul Fetahu

